

## Mbajtja e të dhënave në mënyrë të sigurtë

### Standardi ISO/IEC 27040:2015



Magazinim dhe mbrojtje e sigurtë e të dhënave kërkon më tepër sesa thjeshtë një kopje rezervë. Një standard i ri ndërkombëtar për sigurinë e ruajtjes së të dhënave bën të mundur që informacioni i vlefshëm të jetë në duar të sigurta.

Të dhënat e një organizate apo kompanie, shpesh, janë pasuria e saj më e vlefshme, dhe mbajtja e tyre në mënyrë të sigurtë dhe efektive po bëhet gjithnjë e më shumë një domosdoshmëri komerciale dhe ligjore. Megjithatë procesi i menaxhimit mund të jetë i ndërlikuar, duke përfshirë jo vetëm mënyrën se si janë magazinuar të dhënat, por edhe se si t'i aksesojmë në mënyrë të sigurtë dhe t'i transmetojmë përmes një game të gjerë mjetesh komunikimi dhe pajisjesh elektronike bashkëkohore.

**Standardi ISO/IEC 27040:2015: “Teknologjia e informacionit - Teknikat e sigurisë – Siguria e ruajtjes”**, jep udhëzime të hollësishme teknike se si të menaxhojmë në mënyrë efektive të gjitha aspektet e sigurisë së ruajtjes (magazinimit) të të dhënave, që nga planifikimi dhe projektimi deri tek implementimi dhe dokumentimi.

Ai përfshin udhëzime për lehtësimin e rreziqeve për prishjen e të dhënave dhe të korrupsionit (dëmtimit) të tyre dhe merr parasysh teknologjitë e reja dhe kompleksitetin e lidhjes dhe mbështetjet në kërkesat e një Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, sipas standardit **ISO/IEC 27001:2013: “Teknologji informacioni - Teknikat e sigurisë - Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit – Kërkesat”**.

Standardi i ri që po hartohet, **ISO/IEC 27040:2015** ka si qëllim të:

- ndihmojë në tërheqjen e vëmendjes kundrejt rreziqeve;
- të asistojë organizatat për një sigurim më të mirë të të dhënave nga momenti kur ruhen;
- të sigurojë një bazë për auditimin, hartimin dhe rishikimin e kontrolleve të sigurisë së ruajtjes.

#### **Si mund t'i bëni tuajat standardet!**

1. Standardin **S SH ISO/IEC 27001:2013: “Teknologji informacioni - Teknikat e sigurisë - Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit – Kërkesat”**.

**Statusi:** Publikuar

**Gjuha:** Anglisht

**Faqe:** 25

**Çmimi:** 3570 lekë

#### **Standardet ndërkombëtare që lidhen**

Ky standard është ekuivalent me:

ISO/IEC 27001:2013 ISO/IEC JTC 1/SC 27

**Komiteti Teknik:** 224 - Sisteme të perpunimit të informacionit

**ICS:** 35.040 - Hapësira të karaktereve dhe të kodimit të informacionit

2. Për të më tepër informacion rreth standardeve të Serisë ISO/IEC 27000 dhe nëse standardi i ri, **ISO/IEC 27040:2015**, Ju nevojitet për ta përdorur si Standard Shqiptar (S SH) na kontaktoni ose vizitoni zyrat tona në adresën Rruga: “Mine Peza”, Nr. 143/3, 1014 – Tiranë, Shqipëri.